



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 14

Prishtinë, më 6.2.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla –S 1

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

**Munguan:** Glauk Konjufca, dhe Arben Gashi.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Abelard Tahiri- Ministër i Drejtësisë, Ardian Bajraktari, Qemajl Marmullakaj, Berita Abazi dhe Liridon Haxhiu, MD; Besim Kelmendi, Shqipdon Fazliu dhe Flakron Sylejmani, ZKPSH; Labinot Leposhtica, BIRN; Artan Demahasaj dhe Genc Nimoni, ÇOHU; Artan Murati, KDI; Drita Vitia. Radio Kosova; Diana Berisha, IKD; Rreze Hoxha, GLPS; Sanije Berisha, OSBE; Ardiana Thaçi, KTV; Saranda Ramaj, Koha Ditore; Donika Osmani, Ekonomia Online; Betim Musliu dhe Ehat Miftaraj, IKD.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Nga staffi mbështetës:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16.1.2018;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034;

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr.06/L-14 për Infrastrukturën Kritike;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214;
6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
7. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës;**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16.1.2018;**

**Kryetarja** konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbajtur me datë 16.1.2018, pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034;**

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorinë e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-034 dhe tha se në ndryshimit që janë bërë në projektligj, ne si komision konsiderojmë se ato janë problematike, prandaj ne e kemi ftuar ministrin e Drejtësisë z. Abelard Tahiri për të na sqaruar për propozimin që vjen nga Ministria e Drejtësisë. Kam vërejtje për secilin plotësim-ndryshim që është bërë, ndërkohë që pyetja ime është se përse keni menduar që duhet të fuqizohet kryeprokurori i shtetit, duke ia marrë kompetencat Këshillit Prokurorial dhe po ashtu pse është hequr 25% për prokurorët, përderisa është një praktikë e mirë që po ndiqet.

**Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë,** tha se në kuadër të këtij projektligji ka ndërhyrje në Ligjin bazë për Prokurorin e Shtetit si dhe në amendamentet e vitit 2015. Ndërhyrjet janë bërë kryesisht në amendamentet që i janë bërë Ligjit bazë, të vitit 2015, janë gjithsej 6 ndryshime më të rëndësishme, duke i përmendur me radhë: rishikimi i kriterëve për emërimin e prokurorëve në Prokurorinë Speciale dhe ekuivalentimi i tyre me kriteret për emërimin e prokurorëve në Departamentin për Krime të Rënda, kjo me qëllim të rritjes së numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, si dhe rritjes së efikasitetit në parandalimin dhe luftimin e krimeve për të cilat është kompetente Prokuroria Speciale; Mundësinë që kryeprokuror i shtetit të mund të caktojë prokurorët në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, sipas nevojave urgjente dhe ngarkesës me lëndë në këtë prokurori; Caktimi i prokurorëve është i përkohshëm dhe atë deri në 1 (një) vit me mundësi të vazhdimit edhe për një vit tjetër, po ashtu mund të caktojë me vendim prokurorë për të mbështetur kryeprokurorin e shtetit në ushtrimin e kompetencave të tij mbikëqyrëse dhe administrative; Heqjen e kufizimit prej 25% të pagës bazë si, për kompensimin e tyre për punën dhe angazhimet jashtë orari. Me qëllim që stafi administrativ prokurorisë të vazhdojë të ketë statusin e shërbyesve civilë, është fshi dispozita që i referohet nxjerrjes së një ligji të ri, pasi që kjo është e panevojshme, për faktin se legjislacioni për shërbyesit civilë është mjaft i avancuar. Gjithashtu harmonizohet edhe në aspektin terminologjik me ndryshimet sa i

përket institucionit kompetent për trajtime, ngase tashme kompetent për ofrimin e trajnimeve është Akademia e Drejtësisë. Projektligji ka për qëllim ngritjen e efikasitetit në shkallë më të lartë të sistemit prokurorial, duke mundësuar caktimin e prokurorëve me qëllim të efektivitetit më të madh në punë. Me këtë rast dëshiroj të theksoj se përmes miratimit të këtij Projektligji në masë të madhe do të ndikojë në shtimin e numrit të prokurorëve në Prokurorinë Speciale, si dhe kësaj prokurorie do ti mundësojë kryerjen e funksioneve të saj me qëllim të luftimit sa më të suksesshëm të korrupsionit, krimit të organizuar dhe veprave tjera për të cilat Prokuroria Speciale është kompetente, e ky ka qenë qëllimi dhe synimi im.

Z. Tahiri theksoi se një propozim i tillë është në pajtim me Kushtetutën dhe përgjegjësitë që ka Këshilli Prokurorial i Kosovës. Për më tepër, ky projektligj dhe pakoja e Projektligjeve që do të vijë shumë shpejt në Kuvend, eliminojnë pikërisht një defekt të legjislacionit aktual.

Me nenin 22 paragrafi 3 të Ligjit në fuqi për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili ndër të tjera thekson se për raste të jashtëzakonshme, kryeprokurori i shtetit mundet përkohësisht të transferojë në një prokurori tjetër. Transferimi i ndërmarrë sipas kësaj dispozite nuk mund të tejkalojë 30 (tridhjetë) ditë përveç nëse Këshilli miraton një periudhë më të gjatë'. Pra unë besoj se me këtë Projektligj sistemi juridik në Republikën e Kosovës do të arrihen qëllime të shumta, e ndër to më të rëndësishmet është lufta më efikase kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërkaq ky projektligj është pjesë e obligimeve tona si shtet që ndërlidhen me agjendën për Reforma Evropiane- (ERA), e rrjedhimisht kjo është e ndërlidhur me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, në të cilën ceket hartimi i Projektligjit për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Prokurorinë e Shtetit. Finalizimi i këtij projektligji është bërë në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Shtetit si dhe me partnerët strategjik.

**Besim Kelmendi, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit,** tha se nga 6 nene që janë propozuar për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, vetëm 4 nene kanë të bëjnë me ndryshime funksionale sepse 2 nenet e fundit kanë të bëjnë me fshirje të nenit që e kanë humb kuptimin për të ekzistuar në ligj. Në lidhje me këto nene ku janë propozuar ndryshime, qëllimi kryesor është ngritja e efikasitetit të punës në Prokurorinë e Shtetit dhe në veçanti punën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e cila përkundër përpjekjeve maksimale të Prokurorit të Shtetit për të plotësuar vendet në këtë Prokurori, ka qenë e pa mundur që të plotësohen. Qëllimi ka qenë që të zgjatet 30 ditshi sepse ende pa marrë raportin fillestar nga policia apo pa e marrë në pyetje ndonjë dëshmitarë, të pandehur apo të dëmtuar, mandati i prokurorit kryhet dhe kthehet në zyrën e vet. Pra, rrisim efikasitetin duke marrë parasysh dispozitën e Kodit të procedurës Penale, që lejon një afat të hetimeve prej dy viteve, ndërsa me leje të gjykatës edhe 6 muaj. Mirëpo, ne kemi kërkuar që së paku me rastet emergjente ku thotë Kryeprokurori cakton raste emergjente dhe besoj që mund të na ndihmoni edhe si komision nëse e bëni edhe përkufizimin se çfarë nënkupton rast emergjent sepse rasti emergjent nuk është procedurë e zakonshme, ngase, nëse 5 apo 6 prokurorë pensionohen apo dalin avokatë dhe mbetet prokuroria speciale pa prokurorë, atëherë e kemi problem të caktojmë prokuror vetëm një muaj.

Çështje tjetër që është ngritur është caktimi i prokurorëve për ta mbështetur Kryeprokurorin në ushtrimin e kompetencave mbikëqyrëse dhe administrative, ku tha se nuk bëhet fjalë për prokurorë që do të kryejnë detyrën nga kompetenca e kryeprokurorit të shtetit sepse nuk kanë drejtë të kryejnë

asnjë rast. Pra, këta do ta mbështesin Kryeprokurorin e Shtetit, do ta mbështesin për çështje administrative, si fjala vjen për ndihmë juridike ndërkombëtare apo marrëdhënie ndërkombëtare.

Kelmendi sqaroi edhe qëllimin e ndryshimit të nenit 11 paragrafi 2, të ligjit aktual, ku tha se kjo dispozitë ndryshohet që mos të ketë mundësi për interpretime të ndryshme sepse fjala 'juridiksion' nënkupton kompetencën e Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit edhe për të bërë hetime për ndonjë rast të caktuar. Propozimi për ndryshimin e kriterëve për emërim të prokurorëve në departamentin e krimeve të rënda dhe Prokurorinë Speciale, në mënyrë që të kemi prokurorë më shumë në këto departamente.

Ndërsa, sa i përket nenit 3, ku është propozuar që të fshihet paragrafi 4 i nenit 11, tha se kemi shumë ligje që ne i kemi obliguar prokurorët që të marrin pjesë në komisione të ndryshme dhe qëllimi ka qenë që me këtë, ky ligj të jetë në përputhje me ligjet tjera që të rregullohet në atë mënyrë, ku askush mos të dëmtohet por edhe askush mos të përfitojë nga këto ndryshime ligjore.

**Albulena Haxhiu, kryetare, theksoi se** sa i përket nenit 1, shqetësimi im është se në sistemin e drejtësisë tonin shumë më lehtë është i kontrollueshëm një individ sesa një sistem dhe sipas interpretimit tim, në çdo projektligj që po procedohet në Kuvend, po tentohet që të fuqizohet vetëm Kryeprokurori i Shtetit. Kjo gjë është rrezikshme, pikërisht me problemet që kemi në sistemin e drejtësisë. Në një hulumtim parlamentar që ka bërë Zyra për Hulumtime në Kuvend, në asnjë nga praktikatat e shteteve si në Slloveni, Maqedoni, Shqipëri, Kroaci, Gjermani, Suedi, Finlandë, ku në asnjërin prej këtyre nuk është e rregulluar siç po propozohet të bëhet këtu.

Sa i përket caktimit të prokurorëve në Prokurorinë speciale të Kosovës, konsideroj që bie ndesh me nenin 110 të Kushtetutës sepse këtë kompetencë e ka Këshilli Prokurorial i Kosovës, i cili obligohet të sigurojë një sistem funksional dhe me këtë propozim po fuqizohet Kryeprokurori i Shtetit dhe po dobësohet Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Sa i përket heqjes së 25% që ligji thotë se mund të ushtrojnë veprimtari profesionale të prokurorëve jashtë orarit të punës dhe besoj se ne e kemi rregulluar mjaft mirë, që nëse hiqet me ndryshimet aktuale, nuk besoj që mund të shkojë përpara sistemi i drejtësisë, gjë që jam mjaft e shqetësuar.

Gjithashtu, si do të rregullohet statusi i stafit administrativ sepse kanë një rol mjaft të rëndësishëm në sistemin e drejtësisë dhe pse nuk është nxjerr ligj i veçantë dhe po hiqet diçka si pasojë e neglizhencës së Ministrisë së Drejtësisë.

Haxhiu theksoi se për këtë Projektligj kemi marrë kundërshtime edhe nga organizata që e mbështesin Kuvendin, si Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe nga IKD-ja. Edhe Zyra Evropiane, sipas kontakteve të mia, e kundërshtojnë fuqishëm heqjen e 25%.

**Sami Kurteshi**, në diskutimin e tij tha se në nenin 1, ku thotë shtohet fjalia përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale si pjesë e ushtrimit të funksioneve prokuroriale.” duket si një formulim gjuhësor i përgjithësuar, që shkel përcaktimin ligjor sepse sipas kësaj fjalie mundet kryeprokurori ose një

deleguar i prokurorit të marrë çdo lëndë dhe ku është kompetenca lëndore dhe territoriale. Pra, lënia e çështjeve publike të papërcaktuara me ligj është e rrezikshme sepse çon në arbitraritet. Ndërkaq, në lidhje me heqjen e 25% z. Kurteshi theksoi se çdo njeri që mban dy ose më tepër vende të punës, asnjë punë nuk e kryen ashtu si duhet. Gjithashtu tek ulja e kriterit për zgjedhjen e prokurorëve në Prokurorinë Speciale, tha se neni 110 i Kushtetutës e përcakton zgjedhjen e prokurorëve dhe caktimi në bazë të këtij propozimi po bëhet në mënyrë arbitrare. Kurteshi theksoi që është kundër këtij propozimi që të vendosë një individ arbitrarisht në zgjedhjen e prokurorëve në Prokurorinë Speciale, duke përmendur si rast zgjedhjen prokurorit Sylë Hoxha.

**Hajdar Beqa**, tha se dy nenet e fundit të Projektligjit janë plotësim-ndryshime teknike, ndërsa nenet 1 dhe 2 të projektligjit i mbështes sepse konsideroj që ndikon pozitivisht për avancimin dhe zhvillimin e sistemit prokurorial. Ndërkaq, tek neni tre, në të cilën hiqet 25%, a ndikon në efikasitetin e punës së prokurorisë nëse hiqet 25%, ashtu siç është propozuar në projektligj. Në nenin 4 të Projektligjit, 'Paragrafi 2 i nenit 12 të Ligjit të ndryshuar, fshihet nga teksti' dhe me këtë propozim a do të ndikojë në efikasitetin e punës së administratës sepse Prokuroria pa administratën nuk mund të funksionojë. Dua të theksoj se ky projektligj është shumë i rëndësishëm dhe nëse mund të na tregoni se si e kanë të rregulluar këtë çështje vendet tjera. Në fund z. Beqa tha se në parim e mbështet këtë plotësim ndryshim të projektligjit.

**Bilall Sherifi**, tha se ideja për të ftuar ministrin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ishte që të na sqaronte se përse janë bërë këto ndryshim-plotësime, ndërsa pikëpamjet tona ne mund ti japim në mbledhje të Komisionit. Duke e ditur që Kryeprokurori punën kryesore ka administrimin e punës së Prokurorisë, sa do të mund ta pengonte punën e administrimit në prokurori duke pohuar se ka dilemat e tij rreth kësaj çështje sepse nuk do të dimë më pas, se kujt do ti kërkojmë llogari.

**Nezir Çoçaj** theksoi se sigurisht shumica e qytetarëve nuk janë të kënaqur me organet e sistemit të drejtësisë, KPK, KGJK apo me prokurori dhe gjykata nëpër komuna ku janë. Të falënderoj për përkushtimin tuaj që doni të bëni reforma dhe që këto ligje të jenë sa më praktike dhe pragmatike për jetën e qytetarëve, duke e ditur që ka shumë lëndë. Hetimet mund të zgjasin 2 vite dhe unë po sugjeroj që të jetë 2 vjet hetimi dhe jo 1+1, me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj, duke pasur parasysh që praktikant kanë treguar se shumë lëndë kanë mbetur në gjysmë për të mos thënë çerek. Më tej, Çoçaj tha se në një aspekt është pozitive që ka prokurorë dhe gjykatës që kanë grada shkencore dhe punojnë në universitete, por unë kërkoj që të punohet pas orarit të punës dhe po ashtu të kërkohej vlerësim i performancës të punës së çdo prokurori.

**Korab Sejdiu**, tha se fillimisht do të doja që mos të bëjmë shumë ndryshim plotësime të ligjeve sepse si parim parësor e kemi që të bëjmë ligje që janë më lehtë të zbatueshëm edhe për ju, por edhe më i kuptueshëm për qytetarët dhe nëse ndryshohet njëherë, herën e tretë të shkojmë me ligj të ri. A ka probleme në lidhje me padëgjueshmërinë e prokurorëve për të adresuar raste specifike, pasi që unë jam ithtar i asaj që kur kërkon përgjegjësi nga kryeprokurori, duhet t'ia japësh edhe mjetet e punës dhe në parim e përkrah për të forcuar kryeprokurorin e shtetit. Në dijeninë time kryeprokurori ka punë shumë në menaxhim dhe administrim dhe thjesht do kisha pasur dëshirë me ditë për të marrë punë shtesë, e ka që nuk po e dëgjojnë prokurorët dhe nuk i zbatojnë urdhrat apo është diçka që ne nuk e kemi parasysh, ndaj kërkoj arsyen bazë, pse po e kërkonin këtë. Sa persona i keni ndëshkuar që nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre dhe këtu e kam fjalën tek kualiteti, se

ideja është që të kemi një prokurori kualitative dhe të bëjë aktakuza kualitative dhe arsyetoni pse duhet të hiqet 25 %.

**Shkumbin Demaliaj**, në fjalën e tij tha se me plotësim ndryshim të këtij ligji a rritet efikasiteti i punës në prokurori? Në lidhje me heqjen e 25% , duhet të shohim se mos kemi kolizion të ligjeve, përndryshe në parim jam për këtë ndryshim sepse në të ardhmen mendojmë të jemi në fazë integruese.

**Albulena Haxhiu**, kryetare, tha se i janë shtuar shumë kompetenca kryeprokurorit të shtetit, duke e propozuar edhe për kryetar të provimit për Jurisprudencë dhe ende po i jepni kompetenca hetuese dhe ndjekjes penale të cilat janë të panevojshme propozimet e tilla. Sa i përket kritereve për prokurorë specialë, tani së fundmi kemi një rast që është pranuar pa i plotësuar kriteret si prokuror në Prokurorinë Speciale.

**Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë**, tha se Prokuroria e shtetit kohën e fundit është ballafaquar jashtëzakonisht me kërkesa nga jashtë, duke pohuar se pavarësisht që na vinë kërkesa nga vende mike, jo shpeshherë na vinë kërkesa që nuk e ndihmojnë edhe interesin e Kosovës. Tahiri tha se ideja është të fuqizohet institucioni dhe jo individ. Ndërsa, sa i përket rasteve me Serbinë, neve na është dashur përvoja e prokurorëve, jo ekspertëve profesorëve, sa i përket raporteve me Serbinë, që në asnjë rrethanë mos të cenohet integriteti i sovranitetit tonë për rastin e fundit të vrasjes së Oliver Ivanoviqit, prandaj këto ndryshime bëhen që kryeprokurori të ketë mbështetje në kohë të caktuar nga prokurorët, që mund të jenë pjesë e Zyrës së Prokurorit të shtetit. Gjithashtu, sa i përket heqjes së 25 %, kjo rregullohet edhe me pakon e re ligjeve të gjyqësorit, që është në linjë edhe me këtë projektligj që po shqyrtohet sot.

Sa i përket statusit të stafit administrativ, së bashku me Kryeprokurorin dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, kemi menduar që kjo çështje të rregullohet konform Ligjit për Shërbim Civil, kurse sa i përket pyetjes për rishikimin funksional të sundimit të ligjit, Ministria e Drejtësisë në planin e saj i ka 18 projektligje që lidhen me fushën e drejtësisë dhe me rishikim funksional do të nxirret një dokument që do të rekomandojë institucionet e Kosovës se si do të veprohet më tutje.

**Sami Kurteshi**, tha se shqetësim imi është sepse nuk kërkohet integrimi i bashkëpunëtorëve profesionalë dhe numri i tyre në gjykata dhe prokurori lë për të dëshiruar, ku tre prokurorë apo tre gjyqtarë punojnë, kanë vetëm një bashkëpunëtor profesional.

**Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë**, ishte në të njëjtën linjë shqetësimi, i cili shtoi se për vitin 2018, janë në plan 300 vende të reja të punës në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës, në të cilën ka edhe bashkëpunëtorë profesionalë, që do ta lehtësonte shumë punën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**Besim Kelmendi, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit**, sqaroi se zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e ka vetëm një prokuror dhe me këtë propozim po kërkohet të ketë mbështetje më të madhe për çështje administrative. Çdo vendim që e merr kryeprokurori, duhet të jetë i arsyetuar, ku të përfshihet së paku një nga arsyet që është në ligjin aktual. Asnjë rast nuk mund të shkojë tek kryeprokurori pa u regjistruar në prokurorinë kompetente dhe në bazë të ligjit aktual, pasi është regjistruar ia jep të drejtën që atë rast ta marrë në juridiksionin e vet.

Sa i përket 25%, z. Kelmendi shprehu shqetësimin që gjatë orarit të punës mos ti lë prokurorit asnjë punë shtesë, por nëse ia ndalojmë gjatë orarit të punës prokurorëve, ne duhet të shohim Ligjin për Akademinë Drejtësisë që e obligon prokurorin të ligjërojë në Akademi dhe asnjë ligjëratë nuk mbahet pas orarit të punës në Akademi të Drejtësisë. Sigurisht që ndikon në punën dhe efikasitetin e tij, por është një ligj që e obligon gjyqtarin dhe prokurorin që të mbajnë ligjëratë në këtë institucion. Në Këshillin Prokurorial të Kosovës, secili prokurorë që është i angazhuar duhet të ketë një vendim dhe nëse ai zihet duke dhënë ligjëratë qoftë edhe pas orarit të punës pa një vendim të Këshillit Prokurorial, ai bën shkelje disiplinore dhe mund të largohet edhe nga puna.

Në lidhje me ndëshkimet, janë dy prokurorë që janë degraduar nga Prokuroria Speciale, në Prokurorinë Themelore. Është një prokuror që është dënuar për korrupsion me dënim maksimal prej 5 viteve. Ka edhe prokurorë të tjerë që janë ndjek penalisht dhe janë dënuar, duke pohuar se është plotësisht dakord me ju që duhet prokurorët të disiplinohen.

**Bilall Sherifi**, pyeti se kush do të udhëheqë me prokurorinë kur kryeprokurori me muaj të tërë do të përfshihet në një rast, duke pasur parasysh detyrat e shumta që ka në administrim dhe menaxhim.

**Besim Kelmendi, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit**, duke ju përgjigjur, tha në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit janë edhe prokurorë të tjerë që janë kompetentë të trajtojnë rastet sipas ligjit për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit. Kryeprokurori Shtetit nuk zhvillon procedura hetimore por me rastet merren prokurorët që punojnë në zyrën e tij.

**Shqipdon Fazliu, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit**, sqaroi se në bazë të ligjit, kryeprokurori ka kompetencë ekskluzive. Kryeprokurori mund të bëjë unifikimin e procedurave dhe të gjitha këto shkojnë në favor të efikasitetit të institucionit të prokurorit të shtetit.

Sa i përket uljes së kriterëve, ka shumë avokatë, bashkëpunëtorë profesionalë, zyrtarë ligjorë, që kanë punuar me prokurorë- gjyqtarë të EULEKSIT, që kanë hartuar aktakuza apo aktgjykime me 400- 500 faqe, E kemi shumë vështirë t'i inkuadrojmë në sistem të drejtësisë, pasi duhet të kalojnë fazat që janë të përcaktuara me ligj, ndërsa me këtë propozim ne kërkojmë që ata që janë nivel më i lartë të futen në sistem më të lartë të prokurorisë, duke e hapur sistemin përbrenda me njerëz të rinj.

**Sami Kurteshi**,kërkoi interpretimin e fjalisë “përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale si pjesë të ushtrimit të funksioneve prokuroriale dhe ndër tjera tha se meqë nuk e keni precizuar, fjalia nuk e thotë atë që thatë ju, ose qëllimisht e keni lënë të përgjithësuar. Jam shumë i interesuar sipas parimit ajo që është publike të rregullohet me normë publike, që vlen për të gjithë ne. Ligji është për të zbatuar normat dhe kur zbatohen normat përgjegjësia është në nivel.

**Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë**, tha se do të ndërlidhesha me z. Sherifi në lidhje me kompetencën e prokurorit, duke thënë se, një ambasador i një vendi nga BE-ja më është drejtuar si ministër i drejtësisë për disa preokupime të tyre që i kanë me disa shtetas të Kosovës, të cilët kanë kryer krime në atë vend. Në këtë rast unë normalisht pa dashur të bëjë publike asgjë për punët e prokurorit dhe hetimeve, mirëpo ka dyshime të bazuara për mosecjen në drejtimin e duhur të hetimeve. Dhe në këto raste prokurori, kryeprokurori pa dyshim që mund ta transferojë rastin qoftë

në Prokurorinë Speciale, qoftë në një prokurori tjetër sepse është e rëndësishme në arritjen e qëllimeve që këta njerëz t'i vendosin para drejtësisë.

**Bilal Sherifi**, tha se për të gjitha argumentet që i dëgjova deri më tani dispozita aktuale mjafton nëse jo cili është vizioni, ku doni të dilni a keni pa diku ndonjë vend i cili përmes kësaj reforme ka arrit të rris performancën, ka arrit të ulë shkallën e krimit, ka arrit të ulë rastet e rënda të krimit të organizuar. Pra pyeta për aspektin e vizionit, se a do të jetë kjo më i suksesshëm ky propozim apo aktualisht se kemi të rregulluar dhe këtu nuk po drejtohem si Abelard Tahiri, por si ministër si prokurorë dhe nuk po flas për Aleksandër Lumezin, as për Sylë Hoxhën, ngase ata janë emra të përveçëm që historia do t'i harrojë, ndërsa kryeprokurorë ky vend do të ketë gjithmonë. Pra, kushdo që të jetë, ne po e përgatisim ligjin për institucionin i cili është një mekanizëm që vepron, pa marr parasysh se cilët do të jenë ata individë për atë përgjegjësi.

**Korab Sejdiu**, tha nuk pajtohem me ju që kryeprokurori të ketë kompetencën e kërkuar aktualisht për hetimin dhe ndjekjen penale sepse e para, nuk e kishin kërkuar që ta ketë, e dyta, sa kryeprokurorë aktualë ose në të kaluarën ke pa në Prokurorinë Themelore para një gjyqtari në shkallën e parë, duke e trajtuar një rast? Kompetenca në territorin e Republikës së Kosovës ka të bëjë me kryerjen e funksioneve që i ka në tërë Republikën e Kosovës, dotë thotë, në Prizren, në Prishtinë, Gjakovë apo Pejë. Sejdiu kërkoi që të argumentohet se përse po lypet punë shtesë ashtu si thanë edhe parafolësit e tij.

**Hajdar Beqa**, tha se qëllimi i të gjithëve, i prokurorisë, ministrisë dhe i deputetëve është që të kemi një ligj funksional për prokurorinë. Neni 11 pika 2 I ligjit aktual, parasheh që prokurori i shtetit në bazë të një vendimi me shkrim ka të drejtë në juridiksionin e vet të marrë një lëndë nëse i arsyeton ato tri elementet, neglizhencën, paaftësinë profesionale ose konfliktin e interesit të prokurorit përkatës. Dilema është tek kjo fjali '*përfshirë hetimet dhe ndjekje penale si pjesë e ushtrimit funksionit prokurorial*'. A e mundëson pa arsyetim prokurori me marr lëndën pa ndonjë arsyetim?

**Besim Kelmendi**, sa i përket shqetësimit tuaj në lidhje me këtë çështje, ne jemi të pajtimit që tek 1.3 pas kësaj fjalie të përkojë me një aktvendim të arsyetuar dhe po ashtu ne jemi të gatshëm nëse ju e shihni të arsyeshme që të vijmë të themi arsye shtesë në lidhje me atë se pse duhet të marrë një rast Zyra e Kryeprokurorit, mos të flasim për kryeprokurorin si individë por për Zyrën e Kryeprokurorit të shtetit. Ne mund ti dërgojmë arsyet në formë të shkruar kurdo që ju e shihni të nevojshme, ku jepen sqarime dhe arsyet që po i kërkoni ju, nëse duam që sistemi të jetë efikas, krejt ky është qëllimi i përbashkët, përndryshe individë të caktuar vijnë e shkojnë e të mendojmë për ligje të cilat kanë për t'i zbatuar edhe gjeneratat pas nesh.

**Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë**, kërkoi nga anëtarët e Komisionit ta përkrahin këtë projektligj, duke pohuar se për ne është e rëndësishme çfarëdo ndryshimi që mendoni që duhet të bëni në leximin e dytë, ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me ju. Tahiri theksoi se prej qytetarëve kohëve të fundit ka marrë shumë ankesa në raport me punën e noterëve të Republikës



së Kosovës dhe konkretisht me tarifat e tyre. Ministria e Drejtësisë, do ta përgatis një draft dhe jam shumë i interesuar që këtë ta bëj në bashkëpunim me ju, të konsultohemi dhe në fund drafti të marrë formën finale, duke qenë dhe ju dakord si komision.

**Albulena Haxhiu**, tha se Projektligji për Noterinë tashmë është në komisionin për legjislacion. Grupi punues është në këtë ku kryesuese jam unë dhe anëtarët Korab Sejdiun, Hajdar Beqa, Sami Kurteshi dhe përfaqësuesin nga komuniteti Bahrim Shabani. Arsyeja se pse e kam marrë kryesimin e këtij grupi me mbështetjen e komisioni, natyrisht, është pikërisht për shkak të tarifave. Në takimet që kemi pasur me qytetarë, secili prej nesh në forma të ndryshme, shqetësimi kryesorë i tyre është tarifat e larta të noterëve. Kjo është e rregulluar me akte ligjore dhe mendoj që është gabim. Duhet që të paktën minimumi dhe maksimumi i tarifave të jetë i specifikuar në ligj. Do të bëj maksimumin duke e pasur parasysh gjendjen jo të mirë, të qytetarëve të Republikës së Kosovës, është tepër e rëndësishme që kjo çështje të adresohet sepse do të na lehtësonit punën, nëse do të ishin rregulluar tarifat për noterët.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash **4 për, 2 kundër dhe 1 abstenim**, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

*Të miratohet në parim, Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034*

#### **4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-14 për Infrastrukturën Kritike.**

**Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit**, paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional të Projektligjit nr. 06/L-14 për Infrastrukturën Kritike dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Pasi nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr. 06/L-14 për Infrastrukturën Kritike është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund ti procedohet Kuvendit për Shqyrtim dhe miratim
5. **Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214;**

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional, Projektligjin nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214 dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Pasi nuk pati vërejtje, *kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash, 6 për dhe 1 kundër, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr. 06/L-13 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214, është në është në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm.
2. Projektligji mund ti procedohet Kuvendit për Shqyrtim dhe miratim.

### **6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;**

**Albulena Haxhiu, kryetare,** paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe kërkoi nga anëtarët të deklarohen nëse kanë vërejtje.

**Korab Sejdiu,** tha se lidhur me amendamentet që i kam bërë në këtë ligj, këtu burojnë nga përvoja ime pothuajse mbi një dekadë edhe specializimi im pikërisht në këtë lëmi. Është një ligj me të cilën jam marr edhe në studime edhe në përvojë edhe të gjitha problemet që kanë dal në praktikë këtu në Kosovë me ligjin aktual dhe që kanë qenë të paadresuara nga projektligji që po adresohet para nesh. Kjo është arsyeja pse i kam propozuar këto amendamente. Nuk ka diçka të ndjeshme, as politike, janë thjesht çështje që ju ndihmojnë afaristëve në veprimtarinë e tyre. E kam një vërejtje që besoj duhet ta merrni parasysh. Amendamenti 12 nga deputetja Mimoza Kusari-Lila ka kaluar pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, besoj që amendamenti i saj ka potencial të jetë antikushtetues dhe në kundërshtim me nenin 10, 24, 46, 49 dhe 119 të Kushtetutës. Përkundër qëllimit shumë të mirë që e ka znj. Mimoza Kusari-Lila, është tërësisht e pabazuar kërkesa që ti detyrojmë subjektet private një përqindje të caktuar specifikisht 40 për qind, 50 për qind të bordit të ketë kuotë për gjininë femërore. Për mendimin tim në disa nivele cenon edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës sepse imponon obligime në sektorin privat si të adresojmë punën e tyre e shumë gjëra tjera, po ashtu është në kundërshtim edhe me parimin e ekonomisë së tregut, tregut të lirë, kështu që unë jam kundër. Natyrisht amendamentet tjera i përkrah të gjitha.

**Albulena Haxhiu,** theksoi se sa i përket amendamentit 12, nuk e kuptoj se përse është kundërkushtetues sepse në asnjë rregullim nuk specifikohet gjinia, as burrë, as grua.

**Duhet theksuar se amendamentin 12 të këtij raporti nuk u përkrah nga komisioni me 4 vota kundër 1 për dhe 1 abstenim.**

Pasi diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### **R e k o m a n d i m**

1. Projektligji nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e Zbatueshëm, përveç amendamentit 12.
2. Projektligji mund ti procedohet Kuvendit për Shqyrtim dhe miratim

### **7. Të ndryshme.**

*Tek pika të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim*

Mbledhja përfundoi në orën 15:35.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**